**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË 06.06.2022**

Me datë 06.06.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër.Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija,Bledianë Nika, Nersada Mandija, Tereze Brigja, Aurora Dibra, Tereze Brigja, Ardiana Ndreu, Jona Leqejza, Age Martini, Sabina Danaj, Donika Ndoja, Valbona Doniku, Suada Selimaj, Gezim Galiqi, Erion Metushi, Luan Heta, Oltion Luli, Hilmi Lakti, Avenir Celaj, Marjan Ndershtiqaj, Gerald Hasaj, Lush Marku, Sokol Zaimaj, Blerim Dimnaku, Gjergj Sokoli ,Andi Hallunaj,Luigj Palushi, Arbis Vjerdha, Lindita Nika,

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Prill 2022".*

2. *Diskutime mbi masat që duhen marrë për përfshirjen e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin arsimor parashkollor.(Ref.kërkesë inicuar nga këshilltar nr.8489,dt 26.05.2022)*

3. *Dikutime mbi projekt- aktin për planin lokal për veprimin e zhurmave në mjedis.(Ref. kërkesë inicuar nga këshilltar nr.8488,dt.26.05.2022)*

4. Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për krijimin,organizimin dhe funksionimin e këshillit vendor për sigurinë publike në Bashkinë Shkodër".*

5. Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për kodin e sjelljes dhe parandalimin e konfliktit të interesave të këshilltarit bashkiak".*

6. Pr/Vendim: *"Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit viti 2021,të Bashkisë Shkodër".*

7. Pr/Vendim: *"Për miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë dhe përjashtimin nga pagesa e qirasë të përfituesve të subvencionimit në raport me nivelin e të ardhurave për përfituesit e banesave sociale me qira,administruar nga bashkia Shkodër".*

8. Pr/Vendim: *"Për angazhimin e burimeve financiare të Bashkisë Shkodër për bashkëfinancim në aplikimin nr.Ref: EU4M-CFP1-A2;Për angazhimin për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes së projektit dhe për autorizimin e kryetarit për lidhjen e kontratës së grantit".*

9. Pr/Vendim: *"Për shtesë në buxhetin e vitit 2022 e miratuar me VKB nr.3,datë 05.01.2022"Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër".*

10. Pr/Vendim: *"Për miratimin e ndryshimit të emërtimit të rruga e "Korpusit"në rruga "Kolë Mjeda".*

11. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, para se të vijohet me hedhjen në votim të rendit të ditës, Z.Sokoli kërkon fjalën dhe i ribën thirrje këshilltarëve për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit, sepse për moskrijim të kuorumit shpesh herë mbledhjet nuk realizohen. Pjesëmarrja është detyrim dhe përgjegjësi për secilin anëtarë. Gjithashtu ai kërkon që në mbledhjet e ardhshme të jetë prezent edhe Kryetari i Bashkisë.
Fjalën e merr Kryetarja e Këshillit, e cila sqaron se ekziston një rregullore përsa i përket prezencës së këshilltarëve. Gjithashtu ajo fton Komisionin e ligjeve dhe komisionin e mandateve të gjejnë një zgjidhje për këtë.
Kurse për mosprezencën e Kryetarit të bashkisë flet Zv/Kryetari Z.Deda i cili shprehet se pengesë janë bërë angazhimet e tij.
Z.Vjerdha merr fjalën dhe thotë se nuk mendon se impenjimet e Kryetarit janë më të rëndësishme se problematikat që diskutohen në Këshill. Po ashtu ai propozon që Pr/Vendimi për ndihmën ekonomike të kryhet me votim online / me e-mail, në mënyrë që pagesa e njerëzve që trajtohen me ndihmën ekonomike të mos vonohet.

Kalohet në votimin e rendit të ditës, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
***Miratohet***

**1.**Mbledhja vijon me Pr/Vendimin *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Prill 2022"*

N/Kryetari i Bashkisë merr fjalën dhe relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.Kryetarët e grupeve shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
***Miratohet***

**2.**Vijohet me pikën 2. të rendit të ditës: *Diskutime mbi masat që duhen marrë për përfshirjen e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin arsimor parashkollor.(Ref.kërkesë inicuar nga këshilltar nr.8489,dt 26.05.2022)*

Fjalën e merr Znj.Leqejza, e cila relaton në bazë të materialit dhe statistikave të përgatitura në Power Point. Ajo thekson se vërehet që në buxhetin e Bashkisë Shkodër nuk është menduar për përfshirjen/mbështetjen e këtij target grupi fëmijësh, si financiarisht ashtu dhe me mësues dhe specialistë të fushës, të cilët në një farë mënyre janë "përjashtuar" nga sistemi shkollor. Ajo kërkon mbështetje nga ana e bashkisë për lehtësi financiare për familjet e këtyre fëmijëve, për angazhim të specialistëve dhe mësues për to, në mënyrë që fëmijët më aftësi ndryshe të marrin vëmendjen e duhur. Z.Leqejza ka edhe disa pyetje për Zv/Kryetarin. Ajo kërkon të dijë, se sa fond është parashikuar për mësues mbështetës dhe a mund të riorganizohen kapacitetet ekzistuese?

Z.Deda, shprehet se ai vlerëson dhe mbështët nismën për përfshirjen e fëmijëve me aftësi ndryshe. Megjithatë ai shton se një përgjigje më të sakta mund ta japin punonjësit e drejtorisë përkatëse.

Fjalën e merr Znj.Nika,e cila shton se Zyra Arsimore Ekonomike në Bashkinë Shkodër, vazhdon të përballet me një sfidë përsa i përket standarteve që pushteti vendor ka për institucionet arsimore.Problematikë kryesore mbetet edhe infrastruktura e këtyre institucioneve për ofrimin e shërbimit të duhur për këto fëmijë,sepse edhe fondet e alokuara janë të pakta.

Z.Deda, rithekson se fëmijët me aftësi ndryshe janë sfidë jo vetëm për Bashkinë e Shkodrës por edhe për shoqëri shumë të zhvilluara.Ai shprehet dakort për mbështetjen që duhet ofruar dhe po ashtu është në dijeni për vizionin dhe mundësitë e Bashkisë në këtë drejtim. Ai shton se Bashkia disponon evidenca dhe ka bërë monitorimet e nevojshme.Nuk kanë munguar as edhe përpjekjet gjithashtu sipas mundësive financiara. Ai thekson se mbeten të hapur për cdo bashkëpunim.

Përsëri fjalën e merr Znj.Nika e cila pyet, se sa i njohin punonjësit e administratës problematikat e këtyre fëmijëve dhe të arsimit në përgjithësi?

Z.Deda sqaron edhe njëherë se Bashkia e Shkodrës ka informacionin e duhur dhe evidencat e nevojshme për problematikat në fjalë dhe mendon se situata nuk është aq gri sa ç'paraqitet.

Z.Mandija merr fjalën dhe shpreh gadishmërinë në emër të komisionit për mbështetje dhe angazhim në zgjidhje të problematikave të lidhura me arsimin parashkollor në përgjithësi dhe për lehtësime për fëmijët me aftësi ndryshe.

Z.Truma merr fjalën dhe sqaron se pika 2 dhe 3 e rendit të ditës nuk kërkon vendimmarrje, dhe meqënëse kourumi i domosdoshëm nuk është në sallë,mbledhja deklarohet e mbyllur.

Sipas rregullores duhet të caktohet edhe data e mbledhjes së ardhshme e Këshilllit Bashkiak,e cila vendoset ditën e hënë,datë 13.06.2022.

*Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 06.06.2022. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).*

*Procesverbali përmban 4 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:*

***Sekretar*** ***KRYETARE***

***Denis LESHA*** ***Brisela KADIJA***